

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për Krime të Rënda, në trup gjykues të përbërë prej gjyqtari Xheladin Osmani-kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarve Shpresa Emra dhe Luan Berisha, si anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fatmire Kastrati, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit E. M. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KP, sipas aktakuzës të PQ në Prizren, PP.nr.97/2010 e dt.18.10.2010, pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit kryesor të datave 17.06.2015, 18.09.2015, 30.11.2015, 01.02.2016 10.03.2016, në prezencën e Prokurorit të prokurorisë themelore në Prizre-Departamenti për Krime të Rënda Mehdi Sefa, të akuzuarit E. M., mbrojtësit të tij av. B. S. dhe D. M., të dëmtuarit A. K. me përfaqësuesin e të, av. D. R., pas këshillimit dhe votimit njëzëri me datë 15.03.2016, muarr dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

E. M.: nga i ati H. dhe e ëma M., e lindura M., data e lindjes... në fshatin K., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, shqipëtar, shtetas i R. të Kosoves, me profesion jurist, penzioner, i martuar, i ati i 5 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se më datë 07.12.2007, në Gjykatën Komunale në Prizren, duke vepruar në cilësi të personit zyrtar-si avokat publik komunal i Prizrenit, në lëndën jashtëkontestimore Ndr.nr.297/02 ku si palë në procedurë kanë qenë propozuesit A. V. nga fshati G., KK Prizren, të cilin e ka përfaqësuar N. V. si dhe R. V., A. V. dhe A. V. të gjithë nga fshati G., kundërpropozuesit Komuna e Prizrenit të cilin e ka përfaqësuar avokati publik komunal E. M. lidhur me kompensimin e palujtshmërisë së eksproprijuar me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për tjetrin dhe shkaktimit të dëmit për Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe të dëmtuarit A. K. në këtë mënyrë i tejkalon autorizimet që i ka në kuadër të kryerjes së detyrave nga kompetenca e avokatit publik komunal duke e arritur barazimin gjyqësor dhe duke ia kthyer palujtshmërit e eksproprijuara nga ana e KK Prizrenit, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.36,14 ha, zona katastrale L., ish pronarëve të palujtshmërive të eksproprijuar me ç'rast i shkakton përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore për tjetrin në shumë prej 15.000 euro për një ari dhe ka shkaktuar dëm material për Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe të dëmtuarit A. K.

-Me këtë ka kryer veprën penale keqpërdorimi im pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KP,

Gjykata në kuptim të nenit 3, 5, 6, 34, 35, 41, 43, 64 dhe nenit 66 si dhe nenit 257 par 1 të KPK-së, të akuzuarit E. M., ia shqipton

GJYKIMIN ME KUSHT

Duke ia vertetuar denimin me burg në kophëzgjatje prej 12 (dymdhjetë) muajve i cili denim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve, nese i akuzuari nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër të njejtë penale.

I dëmtuari A. K., për realizimin e kërkesëa pronësore juridike udhëzohet në kontestin juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 150 (njëqindëepesdhjetë) Euro, në afatin prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren, ka ngritur aktakuzën PP.nr.97/2010, të dt.18.100.2010, kunder E. M. nga fshati K., Komuna e Prizrenit për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga nei 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK, aktakuzë të cilën në të gjitha fazat e shqyrtimeve kryesor ka përfaqësuar prokurori i ishtetit Mehdi Sefa, i cili fjalën përfundimtare, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit E. M., për shkak se ka kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës ose autorizimit zyrtar nga neni 339 par.3-1 të KP. Duke patur parasysh se i akuzuari ka kryer veprën penale gjatë vitit 2007, mirëpo me hyrje në fuqi të Kodit Penal me 01.janar 2013, atëherë në kuptim të nenit 2 të KP, si Ligj më i favorshëm veprën e ricilësojmë me Ligjin e ri shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit nga nei 422 par.1 të KP. Andaj, prokuroria e shtetit kërkon që këtu i akuzuari E. M. për veprën penale të kryer keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KP.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethat në bazë të nenit 73 të KP, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në veçanti të ketë parasysh rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale që fatkeqësisht paraqitet si dukuri edhe në komunat tjera rreth kinse kompetencave të pakufishme të cilët kanë avokatët publik gjatë vendim marrjes avokatit publik komunal, andaj dënimi duhet të ketë edhe efekt të një prevencioni gjeneral që në të ardhmen veprat penale të këtilla këta zyrtar komunal mos të kryejnë duke mbrojtur kështu pronën e komunës por edhe pronën individuale të personave fizik sikundër është rasti këtu me të dëmtuarin A. K.

I akuzuari E. M. në asnjë fazë të procedurës nuk e ka pranuar fajsinë.

Mëqë të akuzuarit, nuk ka pranuar fajsinë, gjykata pastaj administroj me provat, bëri shiqimi dhe leximi i barazimit gjyqësor të Gjykatës Komunale në Prizren Ndr.nr.297/02 të datës 07.12.2007, në aktvendimin mbi shiqimin e këtij barazimi gjyqësor Ndr.nr.297/02 i datës 05.02.2008, në kopjen e planit për gjeodezi dhe kataster si dhe aktvendimi i drejtorisë për çështje pronësore juridike nr.03/3-463-357 datës 14.04.1986, në aktvendimin e SUK dhe banesave

nr.04/4-253-502 të datës 27.08.1986, në vendimin e Drejtorisë për planifikim urbanizëm ndërtimor dhe rindërtim dhe strehim nr.04/4-351-156 të datës 30.05.2002, në vendimin nr.04/4-351-42 të datës 04.08.2008, 04/4-351-252 të datës 04.10.2006, 04/4-351-42 të datës 03.06.2008, në certifikatën Ul.-71813046-00... në emër të V. A., u lexua certifikata e pronësisë Ul.71813046-01... në emër të N. V., është bërë leximi në procesverbalin e inspektorëve të komunës së Prizrenit 1304/5-354 të datës 03.09.2008, shiqimi në shkresën e datës 04.09.2008 me numër të rastit 029-2618/Z të lëshuar nga ekspertja L. R., është lexuar aktvendimin e agjencionit katastral të Kosovës nr.027-395/D+T të datës 26.12.2008, propozimi për anulimin e marrëveshtjes gjyqësore Ndr.nr.297/02 të datës 07.12.2007, aktvendimi mbi prishjen e barazimit gjyqësor Ndr.nr.297/02 të datës 21.06.2010. Bëhet shiqimi në padinë me nr.C.nr.657/2009 të datës 16.04.2010 dhe Ac.nr.344/2010 të datës 10.08.2008.

Pastaj është bërë shiqimi dhe leximi në shkresat e deponuara nga përfaqësuesi i autorizuar i shërbimeve pronësore juridike S. A. dhe ate njoftimit nga drejtoria për gjeodezi dhe kataster, informacionin e historiatit të parcelave të përpiluar nga kordinatori dhe bashkëpunëtori profesional i shërbimit pronësoro-juridik, aktvendimit mbi nr.03/3463-357 të datës 10.10.2006, në shkresat nga ish pronarët e familjes V. dorëzuar Kuvendit Komunal me datën 02.02.1990, kontrata nr. .../83 të datës 10.08.1983, procesverbalit me nr.03.3-465-70 të datës 13.02.1990, në aktvendimin me nr.03/3-466-181 të datës 27.10.1987, është bërë shqimi në aktgjykimit A.nr.1661/88 të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës prej dt.17.01.1989.

Avokati B. S. qëndroj pranë propozimit që të bëhet leximi dhe shiqimi në kontratën Leg.nr./2009 të datës 26.08.2009.

I akuzuari si plotësim gjykatës ia parashtron një procesverbal nr.03/3-465-70 të datës 04.10.1985 që me këtë procesverbal pasi që nuk është arritur marrëveshtja në mes palëve (BVI për banim dhe familjes V.) ku është udhëzuar që lënda ti dërgohet gjykatës për kompenzim.

Në shqyrtimin kryesor të dt. 17.06.2014, degjoj të dëmtuarin A. K., deshmitaret L. R., A. V., në shqyrtimin e dt.18.09.2014, degjoj deshmitarin S. A., dhe avokatin publik pranë Kuvendit të Komunes në Prizren, më dt.30.11.2015, deshmitarin A. H., më dt.01.02.2016 deshmitaren E. S.

Prokurori i shtetit propozoj që i A. K. të ndegjohet në cilësin e dëshmitarit.

Mbrojtësi, avokati B. S. dhe i akuzuari nuk e kundërshtojnë propozimin dhe mbështesin propozimin e prokurores.

I dëmtuari – deshmnitari A. K., në pyetjen e prokurorit ju keni dhënë në këtë çështje penale deri më tash dy deklaratave, njërenë në prokurori përpara prokurorit me datën 04.tetor 2010 dhe tjetrën para trupit të kaluar gjyqësor në seancën kryesore me datën 26.06.2012, a ju kujtohet çka keni deklaruar, deklaron se po, dhe qëndrojnë në tërësi pranë atyre deklaratave të cilat i përmendi prokurorja.

Në momentin kur unë kamë kuptu faktin se më është marrë e drejta e ndërtimit dhe e shfrytëzimit të asaj prone e deri në momentin kur keni ngritur padi për prishjen e atij barazimi a e nuk e kamë njoftuar avokatin publik të komunës lidhur me këtë çështje. Nuk ka pas njohuri dhe

nuk kam shkuar drejtpërsëdrejti të bisedojë me te, sepse nuk e kam ditë, unë kam shkuar atëherë te avokati S. R., i cili më së pari më ka noftuar se unë kam dy troje, në emrin tim, unë i kam thënë skam dy por vetëm një e kam, pastaj unë kam shkuar në shtëpin e S. R. ku më ka udhëzuar që unë ta bëjë një ankesë lidhur e marrjes së vendimit të marrjes së trolit për shfrytëzim , kjo ka ndodhur para se me u bo barazimi i plotëfuqishëm, asnjëri drejtorie asnjë drejtor nuk më është përgjigjur, dhe qëllimi ka qenë që lënda me u bo e plotëfuqishme dhe me u vonu me ankesë.

Në pyetjen tjetër se si e kuptove ti qëllimin e personave për tu vonuar në ankesë dhe kush apo cilët janë ata persona të cilët e kanë pas atë qëllim sipas teje, i demtuari deklaroj se S. R. dhe B. S., përndryshe – zyrtare kjo ende punon në drejtorin përkatëse, e cila ka qenë në shkollë me bashkëshortën time, dhe sa herë që kërkojshim nga ajo për truallin, ajo gjithmon na ka thënë se “hajt sa të teret toka, pastaj shko te R., në katastrof për me marrë një numër të parcelës, unë kam shkuar dhe aty nuk kishte asgjë, dhe sipas meje krejtë kjo ka qenë mashtrim dhe për të më humbur kohë, dhe për mu plotëfuqizu kjo marëveshje. desklaron se nuk e di që këta dy persona që i përmende a kanë fuqi ligjore për me vendosë lidhur me këtë çështje dhe a kanë competence. Tash ai barazim gjyqësor nuk është prishë.

Se çfarë statusi sot ka trolli kontestues për të cilën është bërë barazimi dhe barazimi dhe a është në fuqi, deklaroj se të drejtën e shfrytëzimit të trolit unë nuk e kam, kam parashtrur kërkesën për kompenzim e dëmit e cila më është shkaktuar nga ana e Kuvendit me këtë barazim – marrje të drejte me anë të këtij barazimi gjyqësor ndërsa sa i përket barazimit gjyqësor unë mendoj se me siguri është në fuqi.

Në pyetjen e të akuzuarit se demtuari deklaroj se e ka bërë propozimin për kompenzim të truallit nga Kuvendi i Komunës a është në gjendje me prezentuar me shkrim dhe kohën kur e ka bërë propozimin, i demtuari tha se nuk jam në gjendje tani me prezentu sepse propozimi është në gjykatë, ndërsa sa i përket Kuvendit, unë nuk e di a ka shkuar avokati në Kuvend të Komunës me kërku një propozim të tillë. Thekson gjithashtu se S. R. atëherë ka qenë duke punuar në Kuvendin e Komunës gjerësa më vonë ka dalë si avokat. I bashkangjitem ndjekjes penale dhe parashtrorë kërkesë pronësore juridike për të cilën do të deklarohem në kontestin e rregullt civil.

Deshmitarja L. R., në pyetjen e prokurores se ju e keni dhënë një deklaratë në shqyrtimin kryesor me datën 06.09.2012, a ju kujtohet çka keni deklaru, nëse po a mbeten pranë asaj deklarate, deshmitarja the se po në tërësi mbetem pranë deklaratës të dhënë si dëshmitare në shqyrtimin kryesor të datës 06.09.2012. Gjithashtu deklaroj se kisha me shtu edhe këtë se prokurori i shtetit atëherë në atë seancë më ka thënë se ti je nëshkruese e këtij barazimi gjyqësor, dhe unë iu kam përgjigjur se unë jam përgjegjëse për pjesën time të punës, për gjenezën, për gjendjen në teren, por si rrjedhë procedura e mëtejme mua më intereson.

Unë jam e punësuar në Drejtorin për gjeodezi dhe katastrof në kuadër të KK Prizren, ndërsa në rastin konkret e kam pas cilësin e ekspertit gjyqësor për gjeodezinë.

Në pyetjen tjetër të prokurorit se në cilësi të punësuarës në drejtorin për gjeodezi dhe katastrof a keni njohuri që vendimet të cilat i nxjerrë një drejtor i dërgohet në drejtorit tjera të cilat mund ta kenë një interes nga ai vendim, deklaron se pas luftës nuk janë gjërat si kanë shku përpara, me siguri se cila drejtor ka komuonikuar në mes veti e sidomos drejtoria për urbanizëm dhe katastrof dhe drejtoria për çështje pronësore-juridike, kurse pas luftës janë vjetërsuara ato kanë ngelur nëpër arhiva, fjala për vendimin para luftës. Për vendimet e reja pas lufte komuonikojë në mes drejtorive të lartëcekura në bazë të dokumentacionit teknik bëhet inqizimi

truallit, i dorëzohet drejtorisë për urbanizëm për pranim teknik, kompletohet dokumentacioni për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit, mandej pas pranimit teknik kthehet në gjeodozi dhe kataster dhe bëhet identifikimi i objektit dhe trollit, aty bëhet destinimi i ri. Këto vendime që i marrin këto drejtori se a kanë për obligim dhe a është praktik ti dërgohet avokatit të komunës, nuk e di se a dërgohet avokatit publik.

Në pyetjen e të akuzuarit se në deklaraten e mëparshme ekspertja e gjeodezisë ka thënë se ekziston ende BVI-ja për çështje banesore, a ekziston kjo BVI për çështje banesore, pra ekziston kjo pas lufte, deshmitarja tha se nuk ekziston por në evidencën tona ende figurojnë si prona.

Në pyetjen e të demtuarit A. K.: kur është bërë barazimi gjyqësor, deklaroi se e di që është bërë barazimi gjyqësor, kur kemi shku në teren kjo ka ndodhur shumë herët më duket ka qenë viti 2003 kur edhe kemi dalë në vend të ngjarjes.

Kur kemi dalë në teren me gjykatën kemi konstatu se kanë qenë të drejtuar objekte banimi nga ana e propozuesve plani urbanistik nuk ka qenë i realizuar sa i përket kësaj lagjeje, dhe ndërtesat në atë pjesë të truallit kanë qenë të ndërtuara në mënyrë jo planifikuese dhe aty kemi gjetur 10 objekte të banimit, në atë lagje në ngastrën kontestuese. Në këto parcela, nuk ka figuruar emri A. K. Pas ekzekutimit të barazimit gjyqësor kam kuptuar se është për A. K., dhe aty A. K. nuk ka qenë i përfshirë në atë barazim, por ka qenë familja V., vëllezrit ku aty kanë arritur barazimin gjyqësor. Pjesë e barazimit gjyqësor, ka qenë që familja V. veq kanë qenë shfrytëzim dhe posedim, ku është ekspropriju dhe për këtë nuk kanë marrë kompenzim nga Kuvendi i Komunës dhe në evidencë kemi gjetur se ende parcelat kanë qenë në emrin e tyre (V.), procedura e eksproprijimit ka filluar por nuk është përfunduar, edhe pse ekziston një aktvendim që nuk është realizuar as në teren e as në evidencën katastrale. Parcelat sot figurojnë me pronar familja V., konkretisht një pjesë në emër të R. V. dhe pjesa tjetër e familjes V., A., A., N. V. e tjerë, të cilat këto parcela janë shtiru nga ana e tyre M. K. për 2 parcelat e formojnë në tërësi të trollit ndërtimor.

Deshmitari A. V., në pyetjen e prokurorit, ju keni dhënë një deklaratë në prokurori me datën 30.09.2010 dhe një deklaratë në shqyrtimin kryesor me datën 27.07.2012 a ju kujtohet se çka keni deklaruar atëherë dhe nëse po a qëndroni pranë atyre dy deklaratave, deshmitari deklaroi se qëndrojnë në tërësi pranë deklaratave të dhënë në prokurori dhe në gjykatë të cilat i ceki prokurorja edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, edhe pse më kujtohet se çka kam deklaruar. Të demtuarin A. K., po, enjohë, e kam njoftu pas barazimit gjyqësor dhe me atë rast kam kuptuar se kush është A. K.

Në atë parcellëse kontestues për të cilën është arritur barazimi a se ka ky njohuri, a ka tentu dikush me ndërtu ndonjë objekt, deklaroi se jo ska tentu askush para barazimit ndërsa pas barazimit ka pas tentime për ndërtimin.

Në pyetjen e prokurorit a do të thotë që pushtetin faktik edhe në posedim të atij trolli gjithmonë keni qenë ju, deklaroi se po, ne kemi poseduar ato parcela edhe me listën poseduese ka dalë pronë e jona pa ndryshime.

Gjatë procesit të barazimit dikush nga komuna e Prizrenit apo ndonjë person tjetër fizik nuk na kanë treguar se parcela katastrale kontestuese nga ana e komunës i është nda dikujt si parcelë për ndërtimin e objektit të banimit, vetëm ato por të gjithë parcelat i kanë pas pronarët e tyre dhe nuk ka pasur ndërtime në to.

Se kjo parcelë katastrale i është nda ndonjë personi të tretë në shfrytëzim për ndërtim të objektit banesor, nuk e kam dit dhe nuk kam njohuri.

Në pyetjen e të demtuarit A. K.: a e din ti që afër shtëpisë time është ndërtuar ndonjë shtëpi tjetër, dëshmitari tha se po, e di që pranë atij trualli është ndërtuar një shtëpi, pronar i të cilit është person i tretë.

I akuzuari E. M., a e din dëshmitari se kur ka shkuar A. K. për herë të parë me bager me qelë podrumin në atë parcelë, që këtij i është ndarë deklararon se unë përmendësh nuk e di por ekziston procesverbali i policisë dhe i inspektionit.

I akuzuari ia përkujton datën 03.09.2008 procesverbali i inspektionit për ndalimin e punimeve për hapjen e podrumit, duke ia treguar procesverbalin dëshmitarit, dëshmitari duke parë procesverbali pikërisht bëhet fjalë për këtë procesverbal.

Dëshmitari A. V., në pyetjen e prokurorit të shtetit: ju keni dhënë dy deklarata, njerën para prokurorit me datën 30.09.2010 ndërsa të dytën në gjykatë, 27.07.2012 në shqyrtimin kryesor a ju kujtohet dhe a është kjo deklarata e juaja, si dhe a mbeteni pranë këtyre deklaratave, deklararon se po, më kujtohet dhe qëndrojë në tërësi pranë këtyre deklaratave, dhe për këtë dëshmitar pyetje tjera pyetje askush nuk parashtroj.

Dëshmitari S. A., në fillim dëshmitari deklararon se qëndron në tërësi pranë deklaratës së tij të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 02.11.2012, duke shtuar se prej muajit mars të vitit 2007 gjerë në vitin 2010, kam punuar si bashkëpunëtor në Drejtorin për çështje pronësore juridike pranë Kuvendit Komunal në Prizren.

Në pyetjen e prokurorit se parcela .../.. dhe për .../.. a mundeni me na tregu këto parcela a kanë qenë të regjistruara në shërbimin e katastrit, dëshmitari tha, kam dhënë edhe deklaratën e mëherëshme ku kam deklaruar se parcelat e lartëcekura nuk kanë qenë fare të regjistruara në shërbimin e gjeodezisë dhe katastrit, parcela këto gjindet në lagjen “D.-J.”. A. K. në lagjen “D.” i është nda trolli për ndërtim të shtëpisë dhe e di që kjo i është ndarë në vitin 1980-ta se kjo a u nda në bazë të konkursi për ndarjen e këtyre trojeve për ndërtim, sa e di unë atëherë ka patur konkurs, sa di ate çka kam vërejtur në shkresat e lëndës. Këto troje a janë dhënë në shfrytëzim e jo në pronësi.

Në pyetjen tjetër të prokurorit, a ka pas drejtë Kuvendi Komunal me ia marrë prap këtë truall A. K. ose zyrtaret e drejtorisë, dëshmitari tha se kur i është dhënë vendimi për A. K. në vendim shprehimisht është cekur se nën pikën 1. “Personit i caktuar i ipet parcela me numër të caktuar dhe e thirrur në ngastrat katastrale e caktuar”, ndërsa në pikën 2. të të njëjtit aktvendim pala ose personit të cilit i është ndarë parcela, obligohet që në afat prej 3 muajsh të pajiset me leje ndërtimi dhe në afat prej 3 vitësh obligohet që ta përfundojë objektin ose ti kryejë shumicën e punimeve, ku në të kundërtën nuk i përmbahet, do ti mirret trolli apo e humbë të drejtën mbi shfrytëzim. Se ky trull që është nda A. K. a ka qenë në emër të Kuvendit Komunal, dëshmitari tha se ky truall si dhe gjitha trojet tjera të cilat gjindet në lagjen “J.” kanë qenë prona private, Komuna e Prizrenit me qëllim të ndërtimit të objekteve private banesore ka bërë eksproprijimin e të gjitha pronave private kjo ka ndodhur dikund gjatë viteve 1970-ta. Se çka ka ndodh në vitin 2007 në truallin e A. K., e di që është pru një vendim gjyqësor ku është bërë barazimi në mes të

ish pronarit dhe Kuvendit Komunal. Nuk e di a ka qenë edhe A. K. ku është dhënë pëlqimi i barazimit

Në pyetjen tjetër të prokurorit se a ka Ligj për me u kthye prej ish pronarëve për deeksproprijim, dëshmitari tha se në kuadër të atij Ligji që ka qenë në fuqi ka ekzistuar një nen i cili i ka paraparë afatet për kthimin e pronave të ish pronarit, deeksproprijim nuk përmendet por përmendet fjala kthim i pronës së eksproprijuar pronarit të mëparshëm në bazë të afatave e di se maksimumi ka qenë 10 vite.

Nuk e di se kur A. V., N. V., R. V., A. V., A. V., a është përmbajtur komuna për kthimin e pronave këtyre personave.

Nuk e di që përveç A. K. a është marrë edhe dikujt tjetër prona e cila është dhënë me konkurs.

Në pyetjen tjetër, a din sa ka qenë ajo sipërfaqe që është kthye ish pronarëve V., dëshmitari tha se nuk e di dhe nuk kam njohuri.

Sa i përket të drejtës se kush ka drejtë me marrë këtë vendim për kthimin e pronave për ish pronarët, dëshmitari tha se organi i cili e ka bërë eksproprijimin Drejtoria për çështje pronësore juridike, pra është organ i vetëm që bënë eksproprijimin por edhe kthimin e pronave pronarëve të mëparshëm me eksproprijim.

Ky dëshmitar nuk e din a ka mujtë këto prona me një barazim me ia kthye avokati publik komunal.

Se a është dashtë të pyetet i dëmtuari A. K. dhe të njoftohet ai në rastin e kthimit të trojeve ish pronarit, tha se jo, për arsye sepse e humbë atë të drejtë dhe ka qenë i njoftuar paraprakisht dhe siç cekta më parë atë vendimin i cili nuk i është përmbajtur pikës 2. Të atij vendimi për ndarjen e trojeve nga se A. K. fare nuk ka fillu ndërtimin, ku afati është strikt i caktuar në vendim që nëse personi në afatin 3 vitesh nuk fillon ndërtimin e objektit dhe nuk kryen shumicën e punimeve, atij faktikisht e humbë të drejtën e shfrytëzimit të trolit, shfrytëzuesi i parcelës A. K. ka pas për detyrë për çdo fillim të objektit apo ndërtimit të objektit të njoftojë Drejtorinë e katastrit për regjistrimin e të njejtës, fare nuk ka qenë e regjistruar. Nuk e di se këto parcela në emër të kujt kanë qenë të regjistruara, nuk më kujtohet, që familja V. a kanë parashtruar ndonjë kërkesë degës ku ju keni punuar për kthimin e këtyre parcelave. Gjykata i ka shkresat e lëndës dhe viti i saktë nuk mund të më kujtohet por eksproprijimi është bërë në vitin 1983.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit A. K., avokati D. R., mbështetë fjalën përfundimtare në tërësi të prokurorit të shtetit si dhe aktakuzën të parashtruar theksojmë se nga shqyrtimet e mbajtura dhe nga provat e administruara në këtë shqyrtim është vërtetuar fakti se objekti i barazimit gjyqësor në lëndën jashtëkontestimore Ndr.nr.297/02 të cilën e ka përfaqësuar këtu i akuzuari E. M. ka qenë pronë e të dëmtuarit A. K. me të drejtën e shfrytëzimit mbi këtë pronë asnjëherë komuna nuk ka leshu ndonjë akte apo ndonjë vendim me të cilën do ti merret të dëmtuarit e njejtë e dretjë e shfrytëzimit prandaj as avokati publik e as komuna nuk ka mund të lidhë një ujdj gjyqësore për një pronë për të cilën nuk ka patur të drejtë respektivisht mbi të cilën personi fizik e ka ushtruar të drejtën e shfrytëzimit.

Në fund theksoj se në veprimet e kundërligjshëme të të akzuarit i është shkaktuar dëm i pa riparushëm të dëmtuarit A. K. duke ia mohuar në të drejtë mbi pronën e palujtshme të cilën e ka shfrytëzuar që nga vitit 1986 pa pengesa, nga fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit por edhe

nga provat e administruara në këtë shqyrtim konsiderojmë se në veprimet e të akuzuarit formohen tiparet e veprës penale për të cilën akuzohet andaj i njëjti duhet të shpallet fajtor sipas Ligjit, në fund theksojmë se paraqesim kërkesë pasurore juridike.

Avokati publik i komunës Besim Morina theksoj se Ligji i avokaturës publike i vitit 1977 i cili është abroguar në vitin 2013, në mënyrë gjeneralë i ka paraparë autorizimet e plota të avokaturës publike në raport me Kuvendin e Komunës, çka do të thotë se të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr avokatura publike i ndërmerr jo në emër të vet personal por në emër të një bashkësie komunale me qëllim të rregullimit të shumë çështjeve që kanë interes për komunën. Në këtë kontekst mendoj se edhe veprimet e mëherëshme të avokatit publik nuk kanë qenë të kundërligjeshme kjo me arsyetim se në vitin 2007 nëse është kry ky veprim në vitin 2008 kam një vendim në dosje që Kuvendi Komunal i Prizrenit e miraton të plotë raportin e avokatit publik komunal, gjatë afatit një vjeçar, pra viti 2008.

Kur i shtrohet pyetja se a mundet avokati publik me hy në procedurë të barazimit të trojeve të cilat më herët kanë qenë të eksproprijuar pa një Rregullore dhe Ligj për deeksproprijim dhe ato troje me iu dhënë ish pronarëve, avokati publik nuk diti të deklarohet, deklaroi, citohet, unë nuk mund të lëshohem a mundem apo smundet por në mënyrë të kuartë Ligji mbi dhënjën në shfrytëzim të trojeve e citon “se marrësi në shfrytëzim të truallit e ka obligim ligjor që në afat prej 3 muajëve pas ndarjeve të truallit të ofrojë planin dhe projektin si dhe të aplikojë për leje ndërtimi pas 3 viteve nëse pala nuk ka ndërmarrë kurgja ai exlege e humbë të drejtën e shfrytëzimit të parcelave”. Prandaj këtu avokati publik nuk diti ta shpjegoj se avokati publik a ka apo nuk ka të drejtë të hy në barazim gjyqësor, duke u shprehur qartazi në favor të akuzuarit duke pontencuar vetëm obligimin e shfrytëzuesit, afatet e aplikimit, humbjen e të drejtës së shfrytëzimit etj. Prandaj deklaratën e këtij dëshmitari trupi gjyqësor nuk e muar për bazë.

Dëshmitari A. H., në pyetjen e prokurorit të shtetit: a keni dhënë ndonjë deklaratë rreth rastit, deklaroi, sa e di unë jo. Unë kam punuar si avokat publik pranë Kuvendit të Komunës në Prizren, prej vitit 11.09.2008 gjerë në muajin prill të vitit 2011.

Kamë pranuar pranim-dorëzimin e detyrës avokat nga E. M., për të gjitha lëndët të cilat kanë qenë në punë nga E. M., përndryshe nuk kam qenë i vetmi por ka qenë edhe V. T. dhe ish zëvendësi avokati A. R.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit, meqenëse një kohë keni qenë avokat publik pranë Kuvendit Komunal në Prizreni, jeni njohës i Ligjit mbi avokaturën publike, a ka drejtë avokati publik të hyjë në barazime gjyqësore për të kthyer palujtshmëritë e eksproprijuara më herët pronarëve të vërtetë pa një Ligj mbi deeksproprijimin, dëshmitari deklaroi se nga praktika që unë kam pas si avokat në asnjë rast gjyqësor deri metani nuk kam lidhë ndonjë barazim gjyqësor, në përgjithësi, pa marrë parasysh natyrën.

Në pyetjen e të akuzuarit E. M.: a pajtohet këtu dëshmitari që në nenin 21 të Ligjit mbi eksproprijimin në par.3 që edhe pse nuk është përdorë fjala deeksproprijim në procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente bahet deeksproprijimi nuk përmendet por toka i kthehet pronarit, faktikisht ekziston deeksproprijimi i cili përmendet me një emër tjetër, shpronësimi i palujtshmërive të eksproprijuara dhe atë në par.3 ku thuhet: “vendimi në formë të prerë mbi eksproprijimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të përparshëm të pasurisë të palujtëshme të eksproprijuara nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit (BVI për banim) në afat prej 3

vitësh, ç' prej se vendimi ka marrur formë të prerë, nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punimet e nevojshme në atë objekt. Paragraf.5 pasi të kalojë 10 vjet nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi eksproprijimin nuk mund të paraqitet kërkesë për anulimin e këtij vendimi. A pajtohet dëshmitari me këtë nen të cilin edhe citova dhe u shënua në procesverbal sidomos në par.3 të Ligjit se po ekzistojka deeksproprijimi por me një termë tjetër dmth. Kthimi i pronës ish pronarit, dëshmitari u deklarua se dispozita ligjore ekziston dhe ka qenë në fuqi..

Dëshmitarja E. S., në pyetjen e prokurorit : a ju kujtohet juve lënda në procedurën jashtëkontestimore që keni pasur lidhur me një barazim gjyqësor si palë kanë qenë Kuvendi Komunal në Prizren i cili përfaqësohej nga avokati publik në atë kohë E. M. dhe kundër propozuesëve A. V. e tjerëve, nga fshati G. R.nr.29702 e keni zgjidhur diku në muajin 07.12.2007 si bazë të barazimit ka qenë kompenzimi i trojeve i cili më herët kanë qenë të eksproprijuar dhënja e atyre trojeve ish pronarëve **tha se po, më kujtohet.**

Në pyetjen tjetër se pas 3 vitësh më konkretisht me 21.06.2010 të njëjtin barazim gjyqësor që është arritur në atë kohë ju me një vendim e keni anuluar e keni prishur a ju kujtohet pse e keni prishur këtë barazim atëherë, dëshmitarja tha se arsyet e atij vendimi në atë kohë e kam dhënë në arsyetim dhe qëllimi i prishjes së çdo vendimi në Gjykatën e shkallës së parë është vetëm që të vazhdohet prap procedura në të njëjtin lëndë.

Në pyetjen se a do të thotë në bazë të juve që keni prishur këtë barazim gjyqësor se ai barazim ndërmjet atyre palëve që e kanë kryer barazimin është jo ligjore dhe se këtë fakte ju e keni kuptuar më vonë, dëshmitarja tha se kanë ekzistuar disa prova që gjykata në momentin e lidhjes së marëveshtjes gjykata nuk ka disponuar me prova, se cila kanë qenë ato prova nuk më kujtohet, nga se ka kaluar një kohë bukur e gjatë.

Në pyetjen tjetër, a kanë mujtë me qenë objekt të një barazimi gjyqësor pronat të cilat më herët kanë qenë të eksproprijuara dhe kthimi i atyre përmes barazimit ish pronarëve nga ana e avokatit publik pa një ligj për deeksproprijimin e atyre provave, dëshmitarja tha se Gjykata në momentin e lidhjes së barazimit nuk ka disponuar me provat të mjaftueshme, unë edhe nuk jam kompetent për të dhënë komentimin e Ligjit në këtë moment.

Se kush ka pas për obligim që në procedurën jashtëkontestimore rreth barazimit gjyqësor të ju pais të ju ofrojë me prova, dëshmitarja tha se është praktike që gjykata e cakton nga se janë këto shënime zyrtare me të cilat gjykata nuk disponon.

Në pyetjen e Përfaqësuesit i të dëmtuarit: that se nuk ka pasur prova kur e keni marrur vendimin në vitin 2010, pse është arrite atëherë ky barazim në vitin 2007 në mungesë të provave, dëshmitarja thot se barazimi është arrite me ato prova me të cilat gjykata ka disponuar, por më vonë janë paraqitur prova tjera.

Deshmitari S. R., në pyetjete e përfaqësuesit të demtuarit, gjatë cilës periudhë keni qenë drejtor i shërbimit pronësor juridik në Kuvendin Komunal, dëshmitari tha se e di që kam qenë prej vitit 2004-2006, në vitin 2007 kam qenë koordinator i drejtorisë për çështje pronësore juridike.

Në pyetjen tjetër se a jeni i njoftuar për një raste të barazimit gjyqësor që ka ndodhur gjatë vitit 2007 në Gjykatën Komunale në Prizren ku si palë ka qenë propozuesi A. V. e tjerë nga fshati G., ndërsa Komunën e Prizrenit e ka përfaqësuar avokati i atëherë publik E. M., tha se kam qenë i njoftuar për këtë çështje lidhur me pronën kanë qenë në drejtori për çështje pronësore

juridike, të gjitha shënimet në lidhje me eksproprijimin konkretisht në këtë rast për lagjen “J.” (D.) si dhe për të gjitha eksproprijimet e tjera kanë qenë në drejtorin për çështje pronësore juridike.

Sa i përket pyetjes se si drejtor koordinator a e dini se a ka pas vendim të Kuvendit për arritjen e barazimit gjyqësor, deklararon se në rastin konkret është bërë fjalë për një eksproprijim të madh diku rreth 2.20 ha, ashtu kur ish pronarët kanë paraqitur kërkesë për kompenzim e në të holla ka qenë një shumë atëherë jashtëzakonisht e madhe, dikund 2.5 milion marka, është biseduar në bord dhe në njëfarë mënyrë i është dhënë mundësia avokatit publik komunal që të gjendet një mundësi dhe kompenzimi të zgjidhet në mënyrë tjetër. Mendojë se ndonjë konkluzion ka pas në atë, por nuk jam i sigurte, meqë kjo ka qenë përafërsisht para 8-9 vite.

Në pyetjen se në rastin konkret e keni pasur të njohur e dini se ka pas i dëmtuari një drejtë të shfrytëzimit a e dini se në bazë të cilit vendim i është marrë e drejta e shfrytëzimit të dëmtuarit A. K., tha se në rastin konkret bëhet fjalë për bartjen e të drejtë së shfrytëzimit në tokën ndërtimore të qytetit, do të thotë bëhet fjalë për tokën e cila në procedurën e eksproprijimit është eksproprijuar sipas afatit të paraparë ligjor dhe në bazë të Ligjit për eksproprijim, Ligjin për tokën ndërtimore si dhe vendimin e Kuvendit komunal për ndarjen e trojeve ndërtimore është shpallur konkursi për ndarjen për shkak të ndërtimit të shtëpive familjare në lagjen “J.” në pajtim me planin detaj urbanistik. Në konkurs janë paraparë kushtet në kuptim që secili person ka pasur të drejtë të konkurojë vetëm për një truall, dhe se anëtarët e familjes të këtij personi kanë pasur të drejtë konkursi. Pas ndarjes sipas konkursit Kuvendi Komunal ka marrë vendim për persona të cilët sipas konkursit i kanë marrë trojet dhe i është urdhëruar drejtorisë për çështje pronësore juridike që të merr aktvendime individuale, aktvendimet e drejtorisë për çështjet pronësore juridike kanë përmbajtur mendojë 4 paragrafe në dispozitiv, me paragrafin e parë, që të bartet e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore të qytetit e shënuar sikur trualli ndërtimor ky edhe ky, do të thotë edhe sipërfaqja, masat dhe kufijt, me paragrafin e 2. është shënuar që të obligohet shfrytëzuesi i ri theksojë edhe një herë që në afat prej 3 muajëve, ta sigurojë të gjithë dokumentacionin teknik ndërtimor, dhe që në afat prej 3 viteve, ta ndërtojë objektin ndërtimor apo ti kryejë punët e caktuara ndërtimore në të kundërtën e humbë të drejtën në truallin ndërtimor. Ligji për eksproprijimin dhe Ligji për trojet ndërtimore janë lexspecialis dhe për to nuk aplikohen kurrfarë dispozita tjera të ligjeve të tjera. Me vendim të posaqëm të Kuvendit Komunal ka qenë e paraparë për rastet e më vonë edhe ka ndodhur që pala në atë moment për ndonjë arsye nuk mund të veprojë sipas afateve të parapara prej 3 muajve apo 3 viteve ashtu që me pajtim me këtë vendim ne si drejtori e sipas kërkesës së palëve kemi marrë aktvendim të posaqëm për vazhdimin e afateve nga par.1 i këtij aktvendimi. Nëse pala edhe në këtë afat nuk ka vepruar sipas aktvendimit do të thotë nuk e ka ndërtuar apo nuk i ka ndërmarrë në afatin e paraparë e humbë të drejtën e bartur në trollin ndërtimor. Në rastin konkret pala të cilën e ka theksuar përfaqësuesi, nuk ka vepruar sipas këtij aktvendimi dhe sipas fuqisë së Ligjit dhe në bazë të aktvendimit e ka humbur të drejtën për bartjen e të drejtës dhe palujtëshmëria e theksuar përsëri është kthyer në fondin e pasurisë shoqërore të komunës së Prizrenit.

Me par.2 të aktvendimit ka qenë e rregulluar e që është paraparë edhe me Ligjin mbi eksproprijimin si dhe Ligjin për tokën ndërtimore dhe vendimin e Kuvendit komunal konkretisht në nenin 64 Ligji për eksproprijim se shfrytëzuesi i ri i cili në afatin e paraparë nuk siguron dokumentacionin nevojshëm teknik ndërtimor apo nuk ndërton objektin ndërtimor sipas fuqisë së Ligjeve të theksuara dhe vendimit të komunës e humbë të drejtën e bartur të shfrytëzimit.

Se a ka të drejtë komuna që në emër të kompenzimit të jep patundshmëri, tha se po ka, në procedurën sipas marëveshtjes për kompenzim.

Në pyetjen tjetër të prokurorit, në bazë të njohurive të juaja që i keni a ka qenë e lejume të bëhet një barazim gjyqësor ndërmjet palëve të eksproprijimit të parcelave dhe kompenzimit të tyre pa një ligj mbi deeksproprijimin e tyre gjegjësisht pa një vendim ose një konkluzion të Kuvendit komunal, deklaroi se në rastin konkret duhet të dallojmë eksproprijimin dhe deeksproprijimin nga bartja e të drejtës së shfrytëzimit. Eksproprijimi është bartja prej pronës private në pasuri shoqërore me kompenzim në pajtim me planin detaj urbanistik, me obligim që shfrytëzuesi i ri pasurinë e eksproprijuar t'ia dedikojë qëllimit në afatin e paraparë. Nëse pasuria e eksproprijuar nuk dedikohet për qëllimin e caktuar atëherë vie në shprehje deeksproprijimi, në rastin konkret toka e cila është dhënë në kompenzim është eksproprijuar dhe është shfrytëzuar për dedikim dmth. është bërë parcelizimi dhe është shfrytëzuar në tokë ndërtimore, do të thotë të eksproprijimit.

Në pyetjen e të akzuarit se deeksproprijimi në procedurën administrative në kuvendin e komunës në rastin konkret nuk është bërë prandaj drejtoria për çështje pronësore juridike landën e kompletuar ia dërgon gjykatës së shkallës së parë për të vendosur, a është procedurë e drejtë ligjore kjo, deshmitari tha se në nenin 51 të Ligjit për eksproprijim është rregulluar që procedura e kompenzimit duhet të kryhet në afat prej 3 muajëve, nga dita e marrjes së aktvendimit të plotëfuqishëm.

Nëse në këtë afat nuk caktohet kompenzimi atëherë drejtoria për çështje pronësore juridike është e obliguar që të gjitha shkresat e lëndës t'ia dërgojë gjykatës kompetent, për caktimin e kompenzimit në emër të eksproprijimit si në rastin konkret.

Gjithashtu theksojë se avokati publik komunal ka qenë gjithnjë i përfshirë në procedurat e eksproprijimit, deeksproprijimit në procedurën e kompenzimit dhe pranë gjykatës.

Në pyetjen e prokurorit, ju në përgjigjet e juaja që keni dhënë sot, keni theksuar se gjatë procedurës së eksproprijimit pason edhe kompenzimi nga ana e shtetit i cili eksproprijon si është e mundur që të kthehen pronarëve të vërtetë pas një periode të kohës po të njëjtat parcela përmes një barazimi gjyqësor pa një Ligj për deeksproprijim edhe pse këta ish pronar kanë qenë të kompenzuar si është e rregulluar, deshmitari, tha se kemi thënë se nuk e ka eksproprijim pa kompenzim. Poashtu kemi thënë se në rastin konkret tokat e cila është dhënë me kompenzim ka qenë pasuri shoqërore me të njëjtën ka disponuar komuna dhe në pajtim me Ligjin ajo ka mundur që tokën e theksuar ta jep në kompenzim siq edhe ka vepruar nuk është e saktë se ish pronarët më herët kanë marrë kompenzim këtë e theksojë me përgjegjësi e poashtu theksojë se edhe në këtë procedurë të kompenzimit të dëmtuarëve janë dëmtuar sepse kanë qenë të pajtimit që me marëveshtje ti ipet 67 ari më pak sipërfaqe.

Unë në drejtorin për çështjen pronësore juridike kam punuar që nga viti 1990 dhe atë saktë në çështjet e eksproprijimit, kompenzimit të nacionalizimit, konfiskimit dhe të tjera. Në rastin konkret eksproprijimi është kryer në vitin 1985 dhe në bazë të shkresave të lëndës të cilat i kam hasur unë ish pronarët nuk kanë marrë kurrfarë kompenzimi deri në marëveshtjen e arritur në gjykatë. Përndryshe unë jam i lindur në fshatin S., jeton në L., por palët janë nga fshati G.

I akuzuari E. M. pas pyetjes së parashtruar nga ana e prokurorit të shtetit se gjatë vitit 2007 në cilat punë dhe detyra keni qenë i angazhuar, deklaroi se shfrytëzon të drejtën e mbrojtjes në

heshtje dhe fare nuk dëshironte lëshohet në mbrojtjen e tij, arsyeja është se të gjitha provat materiale që ekzistojnë në shkresat e lëndës në gjykatën kompetente, në Prokurorin e Qarkut në Prizren dhe të palëve të cilat gjinden në procedure, dhe mbrojtjen e tij u mundua ta jap në fjalën e tij të fundit ku deklaroi kundërshtojë në tërësi konstatimin e prokurorit të shtetit i cili është në kundërshtim me provat materiale të cilat ekzistojnë në shkresat e lëndës, prokurori i shtetit nuk e di kah e ka marrë fjalën deeksprijim kur në barazimin gjyqësor ky term fare nuk është përdorë por është përdorë vetëm kompensimi i palujtshmërive të ekspropriuara të V. e cila palujtshmëri është kompensuar në barazimin gjyqësor nga fondi i pronës shoqërore, një gjë e tillë është e rregulluar edhe me Ligjin mbi eksproprijimin.

Së pari ia fillojë mbi Ligjin e Avokaturës publike neni 4 par.1 ku shkruan “para se të fillojë procedurën civile ose ndonjë procedurë tjetër avokatura publike mund të marr masa të nevojshme me qëllim të zgjedhjes me marëveshje të marëdhënjeve kontestuese”.

Andaj, kjo dispozitë e bënë të paqëndrueshëm mendimin e prokurorit të shtetit dhe përfaqësuesit të A. K., av. D. R. të konstatuar në këtë procesverbal, poashtu si prokurori i shtetit ashtu edhe përfaqësuesi i të dëmtuarit konstatimin e vet nuk e kanë mbështetë në asnjë dispozitë të këtij Ligji.

Në nenin 29 par.1 të Ligjit mbi avokaturën publike shkruan “në përfaqësimin e personave shoqëror-juridik nga neni 26 të këtij Ligji, avokatura publike i ka të gjitha autorizimet të cilat i takojnë përfaqësuesit ligjor të palëve”. Sipas mendimit tim avokati publik komunal është i njëjtë me kompetencat e avokatëve privat, gjyqtarëve edhe prokurorëve duke e shprehë mendimin e vet të lirë dhe për ato edhe nuk përgjigjet për vendimet që i merr me përjashtim nëse është i korruptuar.

Mirëpo, neni 24 i Ligjit mbi eksproprijimin par.1 “pronari i përparshëm është i obliguar që brenda afatit prej 3 vitësh, prej ditës së marrjes së vendimit mbi dhënjen e tokës në shfrytëzim ta ndërtojë ndërtesën” par.2 “nëqoftëse nuk vepron sipas dispozitës nga al.1 e këtij neni pronari i përparshëm hup të drejtën prioritare në shfrytëzimin e tokës në të cilën ka qenë i obliguar të ndërtojë ndërtesën, par.3 “shurja e të drejtës prioritare në shfrytëzimin e tokës nga al.2 e këtij neni caktohet mer vendimin e organit komunal të administratës kompetente për punët juridike”.

Arsyetim në këtë nen është procesverbali i inspektionit të ndërtimtarisë për ndaljen e punimeve zotri K., e që gjindet në shkresat e lëndës.

Vendimi mbi emrimin e avokatit publik komunal nr.01-011-68 datës 05.07.2001 e që është në shkresat e lëndës, vendimi për autorizim të përfaqësimit të KK të Prizrenit pranë Gjykatave kompetente dhe organeve të administratës komunale nr.01/011-28 datës 22.shkurt 2007, e që përfaqësuesi i shtetit ka thënë se nuk ka autorizim, vendimi me të cilin miratohet raporti i punës i avokatit publik komunal i parashtruar për shqyrtim nr.01011-3592 i datës 19.qershor 2008, ku gjindet në shkresat e lëndës.

Në bazë të gjithë këtyre që i cekta, nuk ndihem fajtor pasi që kam zbatuar Ligjet pozitive të cilat janë lidhë me vendin e punës, dhe propozojë gjykatës që të veprojë në bazë të provave materiale dhe të merr vendim lirues.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit A. K., avokati D. R., Mbështetë fjalën përfundimtare në tërësi të prokurorit të shtetit si dhe aktakuzën të parashtruar theksojmë se nga shqyrtimet e mbajtura dhe nga provat e administruara në këtë shqyrtim është vërtetuar fakti se objekti i barazimit gjyqësor në lëndën jashtëkontestimore Ndr.nr.297/02 të cilën e ka përfaqësuar këtu i akuzuari E. M. ka

qenë pronë e të dëmtuarit A. K. me të drejtën e shfrytëzimit mbi këtë pronë asnjëherë komuna nuk ka leshu ndonjë akte apo ndonjë vendim me të cilën do ti merret të dëmtuarit e njejta e dretjë e shfrytëzimit prandaj as avokati publik e as komuna nuk ka mund të lidhë një ujdi gjyqësore për një pronë për të cilën nuk ka patur të drejtë respektivisht mbi të cilën personi fizik e ka ushtruar të drejtën e shfrytëzimit.

Në fund theksoj se në veprimet e kundërligjshëme të të akuzuarit i është shkaktuar dëm i pa priparushëm të dëmtuarit A. K. duke ia mohuar në të drejtë mbi pronën e palujtshme të cilën e ka shfrytëzuar që nga vitit 1986 pa pengesa, nga fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit por edhe nga provat e administruara në këtë shqyrtim konsiderojmë se në veprimet e të akuzuarit formohen tiparet e veprës penale për të cilën akuzohet andaj i njëjti duhet të shpallet fajtor sipas Ligjit, në fund theksojmë se paraqesim kërkesë pasurore juridike.

Avokati B. S. perms autorizuesit av. D. M., gjykates më shkrim ua deponon fjalen përfundimtare, ku i ka theksuar se aktakuza e prokurorisë me nr. PP.nr.97/2010 e dt.18.10.2010 më të cilen akuzohet E. M., i mbrojturi im në të gjitha fazat e procedurës ka mohuar të këtë kryer veprën penale për të cilën pretendon prokuroria. Nga provat që u administruan gjatë shqyrtimeve kryesore, me asnjë prove nuk është vertetue që E. M. ta këtë kryer veprën penale. Nga provat që u administruan ishte barazimi gjyqësor ku konsiderohej se i mbrojturi im e ka mbrojtur pronen shoqërore dhe konsideron se nuk janë shkelur inetresat e Kuvendit Komunal. A. K. iu kishte ndarë një truall nga kuvendi dhe pasi që në afat prej tre vitesh nuk ka ndertuar e ka humbur të drejten që i takon sipas Ligjit, ekspertja e gjeodezisë ku e përshkruan detyren e punës , në mënyrë kronologjike se si pala mundë të fitoj një të drejtë që të jetë titullar i palujtëshmerisë. I demtuari A. K. në vitin 1986, kur është ndar trualli nga Kuvendi Komunal dhe për realizimin e të drejtës së tij, është dashur ti drejtohet organeve kompetente për fitimin e të drejtes ashtu siç pretendon gjatë gjithë proceures i demtuari nuk ofron ndonjë dokument dhe është dashur që mbrënda afatit prej 30 ditesh nga dita e marrjes në dijeni e më së voni mbrënda një viti nga dita e perfundimit e pajtimit gjyqësor. Mëqënsë në rastin konkret ujdia gjyqësore NDR.nr.297/02 rrezullton se është lidhur më daten 07.12.2007, ndersa ky ju është drejtuar organeve kompetente për anulimin e kësaj ujdie që ka parashtuar në gjykatë më daten 19.08.2009. Në këtë rast, është fakt me rëndësi se A. K. i ka kaluar afati objektiv dhe subjektiv në nenin 418 par.4 të LPK-së. Poashtu konsideroj se në mënyrë të drejtë dhe të sakt për vertetimin të gjëndjës faktike ku edhe gjykata sipas detyres zyrtare pas analizimit dhe vlersimit të drejtë të të gjitha provave, ceku se nuk ka shkelje nga neni 181.1 lidhur me nenin 183 të LPK-së, ndërsa pa kurrfar baze ligjore bënë denoncim ndaj avokatit public komunal. Ponjashtu, në shqyrtimin e dt.17.06.2015, ku ekspertja ceku se palujtëshmeria kontestuese në evidencat të cilat i posedon kurr nuk ishte në emer të A. K. Konsideroj se i mbrojturi im me asnjë veprim nuk është vertetu që të këtë kryer veprën penale ashtu siqë është përshkruar në aktakuzë, ku palet kishin kontest ndermjet A. K. dhe familjes V. ku këta të fundit janë titullar të pronave kontestuese.

Poashtu edhe deshmitaret A. V. dhe R. V., të gjith kanë deklaruar se me barazim gjyqësor nr.dr.297/02 të dt.07.12.2007, ku me vetdëshirë pa presion kanë arritur palet marrveshtje për barazim në gjykatë.

Konsideron se Kuvendi Komunal nuk është i demtuar, i mbrojturi im ka njoftuar organet kompetente pergjegjëse për veprimet e ndermarrra për barazim gjyqësor, poashtu në seancen

gjqësore ku është present edhe avokati publik komunal se me barazim gjyqësor Kuvendi Komunal nuk është i demtuar.

Me Ligjin mbi avokatin publik komunal, pikërisht neni 2 alineja 2, poashtu edhe neni 4 al.1 të lëti Ligji, decidivisht është përshkruar se avokati publik i ndermerr të gjitha veprimet me qëllim të zgjidhjes së marrveshtjes në mardhënjet që ti ndermerr veprimet të zgjidhjes të ndonjë kontesti nga organet kompetente.

Sa i përket kalifikimit juridik, konsideroj se mungojnë të gjitha elementet e vepres penale për të cilen pretendon prokuroria. Elementi: perfitimi pasuror i personit të caktuar, të jet shkaktuar pasoja dhe demi konkret ivlerësuar nga organet kompetente se është demtuar Kuvendi Komunal, të ekzistoj lidhja kauzale ndermjet veprimit të personit si dhe pasoja e shkaktuar dhe të përshkruhen disa rrethana dhe fakte të cilat nderlidhen me motivin e vepres penale si dhe me përcaktimin konkret të përfitimit pasuror të personit zyrtar.

Konsideron se i mungojnë të gjitha elementet të këtij dispozitivi të kësaj aktakuze, nuk është verteuan elementet e veprës penale nga neni 339 KPK apo 422 të KP. dhe në fundë propozon që pas analizimi, vlerësimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ku konsideron se trupi gjykues do të vendos në mënyrë meritore ku në mungesë të provave të mirreret aktgjykim lirues.

Trupi gjykues i kësaj gjykate pas mbajtjes së disa shqyrtimeve kryesor kryesore, ka vepruar sipas vërejtjeve të dhënë në bazë të udhëzimeve të Gjykatës së Apelit me provat që janë administruar pamëdyshje është vërtetuar përshkrimi faktik i kësaj vepre penale të kryer nga i akuzuari, në tërësi është vërtetuar se me datën 07.12.2007 në Gjykatën Komonale në Prizren, duke vepruar në cilësi të personit zyrtar publik komunal i Prizrenit në lëndën jashtëkontestimore Ndr.nr.297/2002 ka nënshkruar barazimin gjyqësor me propozuesin A. V. dhe të tjerët lidhur me kthimin e palujtshmërisë së eksproprijuar pa një Ligj paraprak për deeksproprijimin e tyre me qëllim të dobishme të pasurisë kundërligjore për familjen V. ashtu që shkakton dëm në rastin konkret të dëmtuarit A. K. dhe Kuvendit Komunal të Prizrenit, me ç’ rast i tejkalon edhe kompetenca dhe autorizimet që ka në kuadër të detyrave të avokatit publik përmes barazimit gjyqësor ia kthen palujtshmërinë të eksproprijuara në mënyrë arbitrare, duke ditur paraprakisht se Ligji mbi eksproprijimin akoma nuk ekziston në Kosovë, andaj ka qenë edhe e pamundur kthimi i sipërfaqeve të eksproprijuara ish pronarëve meqë ka shkaktuar dëm personave të lartë cekur, Gjykata Komonale në Prizren, këtë barazim gjyqësor me datë 21.06.2010 e prishë, mirëpo dëmi i shkaktuar dhe pasoja nga ana barazim gjyqësor nuk është evituar, nga ky eksproprijim nga barazimi jo të ligjshëm gjyqësor që ka hartuar këtu i akuzuari E. M. si avokat publik komunal i Prizrenit në atë kohë së bashku me A. V. dhe familjarët tjerë ka shkaktuar dëm në veçanti ndaj të dëmtuarit A. K. i cili ka pas vendimin mbi ndërtimin dhe lejen e ndërtimit në lagjen “J.” gjegjësisht “D.” deri në vitin 2008.

Dispozitat e neni 422 par.1 të KP, personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyren apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk përbush detyrat zyrtare të tij me llim që të përfitoj qfardo dobie për vete ose për personin tjetër apo që ti shkattoj dem personit tjetër ose seriozisht ti shkel të drejtast e personit tjetër, denohet.....

Nuk ishte kontestuese se me Ligjin mbi ekpropriimin, pasuria e patundëshme mundë të ekpropriohen ku paraqitet nevoja me qëllim të ndertimit të objekteve ekonomike, banesore komunale, shendetësore etj me interesë të pergjithshëm e këtë Ligji ndër tjera është parapar edhe ekspropriumimi për ngritjen e venbanimeve, në rastin konkeret ndertimin e lagjes D. ish J. në periferi të qytetit të Prizrenit. Me ekspropriumimi që është bërë në vitet tetedhjeta pikërisht në vitin 1986, është bërë ekpripriimi i parceleva në lagjen D. dhe për nevojat e ndertimit të shtepive banesore e gjith kjo hapësirë parcelash është ndar sipas kerkesave që janë bërë pranë Kuvendit të Komunes në Prizren, nga qytetar të shumtë, nder ta ka qenë edhe demtuari A. K. në vitin 1986 ka aplikuar në KK –Prizren, për tja ndar një truall për ndertimin e shtepisë, ku Kuvendi i Komunës i ka dhënë në shfrytëzim dhe lejen e ndertimit. Trolli gjindet në lagjen D. ish J., dhe pas pagimit të taksave i dëmtuar ka filluar të grumbulloj materialin ndertimor, mirëpo për shkak të pengesave nga ish pronaret. Në vitin 2007 me kerkësn e e të demtuarit Kuvendi Komunal në Prizren, për vazhdimin e e lejes së shfrytëzimit të parcelës dhe i demtuari përseri ka filluar ndertimin e, me hapjen apo gropimin e podrumit, dhe kur i demtuari ka shkuar në Kuvendin e Komunës, aty ka kuptuar i demtuari se trolli më të të cilin e ka disponu i aka marrë kuvendi i komunës pa lëshuar kurrfar njoftimi apo vendimi përkates.

I akuzuari E. M. gjatë vitit 2007 ka qenë avokat publik pranë Kuvendit të Komunës në Prizren, dhe ka përfaqësuar në lendën jashtkontestimore Ndr.nr.297/02, ku si pale në procedure kanë qenë propozuesi A. V. nga fshati G. Komuna e Prizrenit të cilin e kanë përfaqësuar N. V., R. V., A. V. dhe A. V., kunderpropozuesit Komuna e Prizrenit, të cilin e ka përfaqësuar i akuzuari E. M., si avokat publik, lidhur me kompenzimin e palujtëshmerisë së ekpropriumuar.

I akzuarit E. M. në cilësin e përsoneit zyrtar –avokatit publik, më datën 07.12.2017, ka përfaqësuar Kuvendin e Komunes, pranë gjykates komunale në Prizren, dhe objekti i barazimit gjyqësor ka qenë lenda jashtkontestimore Ndr.nr.297/02 të cilën e ka përfaqësuar këtu i akuzuari E. M. ka qenë pronë e të dëmtuarit A. K. me të drejtën e shfrytëzimit mbi këtë pronë asnjëherë komuna nuk ka leshu ndonjë akte apo ndonjë vendim me të cilën do ti merret të dëmtuarit e njejtja e dretjë e shfrytëzimit prandaj as avokati publik e as komuna nuk ka mund të lidhë një ujudi gjyqësore për një pronë për të cilën nuk ka patur të drejtë respektivisht mbi të cilën personi fizik e ka ushtruar të drejtën e shfrytëzimit.

Për trupin gjykues ishte kontestuese se këtu i akuzuari a kishte autorizim ligjor që të bëjë barazimin gjyqësor (marrveshtjen) për kompenzim për palujtëshmeri të epropriumuar për pronen. Sipas trupit gjykues këtu i akuzuari një autorizim të tillë nuk e ka patur sepse Komuna e Prizrenit nuk e kishte të drejtën e shfrytëzimit sepse me aktvendimin e drejtorisë për punë pronësore juridike të Kuvendit të Komunës në Prizren nr.03/3-463-375 të datës 14.04.1986 kjo e drejtë është bartë në emër të A. K., respektivisht atij i ishte dhënë e drejta e shfrytëzimit të ngastrave 1075 dhe 1975 të evidentuara si truall ndërtimor me nr.38 për ndertimin e objektit familjar dhe i akuzuari E. M. ka qenë në dijeni për këto rrethana.

Në bazë të vët akzuarit i dëmtuari e ka humbur të drejtën mbi pronën e palujtshme, mirëpo e drejta e shfrytëzimit ashtu siç e ka fituar i dëmtuari me një vendim asnjëherë nuk i është marrë, asnjëher nuk e ka njoftuar dhe nuk e ka paralajmeruar të demtuarin se dot ta humbë të drejten e

shfrytëzimit pasi që i ka skaduar leja e ndërtimit këtë të drejtë i dëmtuari e ka pasur aktive edhe në momentin kur është lidhur ujdia gjyqësore, pra i akuzuari ka tejkaluar autorizimet e veta që i ka patur në bazë të kompetencave të tija si avokat public komunal, nga se i njejt i nuk ka patur të drejtë barazimin gjyqësor me propozuesin V., meqë lënda ende ka qenë në kompenzimin e palujtshmërive të ekspropriuara dhe këto paligjshmëri të ish pronarëve të cilat janë ekspropriuuar më herët nuk mund të kthehen me procedure administrative, ndërsa në procedure gjyqësore palët kanë vetëm të drejtën të kërkojnë kompenzimin e palujtshmërive të ekspropriuara në të holla, ose në palujtshmëri tjera, asesi nuk duhet ti kthehet palujshmëria e ekspropriuuar siç ka ndodhur në rastin konkret e nëse kjo nuk arrihet palët i drejtohen gjykatës kompetente për kompenzimin e palujtshmërise së ekspropriuuar në procedure gjyqësore.

Trupi gjykues nuk mori për bazë arsyetimin e mbrojtësit të akuzuarit, në realitet mbrojtësi asgjë nuk ka thenë atë që ishte të vertetoj pafajsinë e të mbrojturit të tij, të akuzuarit duke cituar aktvendimet dhe autorizimet që i kishte patur i akuzuari si avokat publik pranë Kuvendit të Komunës në Prizren, nuk mundi ta bindë gjykatën se i akuzuari a kishte patur autorizim ligjor që të bëjë barazimin gjyqësor për kompenzimin për palujtëshmeri të ekpropriuuar për pronen për të cilën Komuna e Prizrenit, nuk e kishte të drejtën e shfrytëzimit nga se me aktvendimin e Drejtorisë për punë pronësore juridike të Kuvendit të Komunës nr.03/3-463-375 të dt.14.04.1986 , kjo e drjet është bartur tek A. K.

Trupi gjykues gjithashtu e hodhi si të pabazuar mbrojtjen e të akuzuarit, kur tha se ka marrë të gjitha vendimet në kuader të Ligjit mbi Avukaturen publike neni 4 par.1 ku shkruan “para se të fillojë procedurën civile ose ndonjë procedurë tjetër avokatura publike mund të marr masa të nevojshme me qëllim të zgjedhjes me marrëveshtje të marrëdhënjeve kontestuese”, mirëpo i njejt i Ligj në vazhdim thot mjaft kuart se avokatura publike është e obliguar që përsonat e interesuar ti informoj për masat e marra dhe për rrezulltatit e tyre. Në rastin konkret avokati publik i komunës, këtu i akuzuari ka lidhur marrëveshtjen vetem me përsonat prona e të cilëve u është marrë me eksproprijim pa njoftua fare edhe të demtuarin A. K. të cilit i është dhënë prona në shfrytëzim. Prandaj mbrojtja e të akuzuarit në rastin konkret kishte të bëjë vetëm që ti hik përgjegjësisë penale.

Të gjithë deshmitaret e propozuar e të cilet u dëgjuan gjytë shqyrtimeve kryesore, secili prej tyre nuk diti të spjeron se i akuzuari E. M. në cilësin e avokatit publik pranë kuvendit të komunes në Prizren, a ka patur të drejt të lidhë barazim gjyqësor, secili prej këtyre deshmitarve cituan vetm Ligjin mbi ekproprioimit dhe Ligjin mbi avukaturen publike, përveq deshmitares E. S. e cila konfirmoj edhe njëher aktvendimin e Gjykatës Komonale në Prizren, 297/2002 të datës 21.06.2010, ku ka anuluar marrëveshtja në fjalë, ku pa të drejtë është përfshirë në atë marrëveshtje ish pronarët e familjes V. duke shtuar gjykata në momentin e lidhjes së barazimit nuk ka disponuar me provat të mjaftueshme.

Pra, gjykata në bazë të administrimit të provave, dëshmisë së dëshmitarëve dhe në bazë të vlerësimit të kësaj çështje penale u vërtetu në tërësi se i akuzuari E. M. ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga nei 422 par.1 të KP, meqë në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për çka gjykata të njejtin e

shpalli fajtor për veprën e kryer penale, për çka edhe ia shqiptojë dënimin e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e bindur se edhe me këtë masë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata më rastin e marrjes së vendimin mbi dënimin pati parasysh si rrethanat renduese ashtu edhe ato lehtësues. Si rrethanë renduese gjykata pati parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, motivin e kryerjes, mundësimin nga i akuzuari që tjetëri të perfiton në shkallë të konsiderueshme, keqperdorimin e pushtetit në rastin konkret të pozitës zyrtare ndërsa si rrethanë lehtësues pati parasysh qëndrimin korrekt të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës, është familjar dhe gjerë më tani i padenuar, andaj gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me veprat penale si dhe me sjelljen e të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mi kërkesënpasurore juridike u muar në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësoropër të vendos në kuptim të nenit 450 par. 1 dhe 2 nenp.6 të KPP.

Nga të gjitha që u thane më lartë, trupi gjykues i kësaj gjykate vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.289/2014, dt.15.03.2016

Sekretarja Juridike
Fatmire Kastrati

Kryetari i trupit gjykues
Xheladin Osmani

KËSHILLAT JURIDIKE: kunder këtij aktgjykimi, pala e paknaqur ka të drejtë ankese në fatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykates Themelore në Prizren-për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.